

Dy vjet në detyrë, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi: Ja sfidat që përballuan FA

Sipas shefit të SHP të FA 100-vjetori e gjeti Shqipërinë dhe FA të saj, kontribuuese të paqes dhe sigurisë kudo në botë. Viti 2013, viti i vazhdimit të modernizimit të Forcës Ajrore dhe FD, dhe procesi do të ketë në fokus FT.

Për asgjësimin e municioneve janë dhënë vlerësimi

nga NATO dhe OSBE. Arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit ka qenë objektiv i rëndësishëm i FA. Stërvitja në të gjitha nivelet është parë si një tregues i rezultateve...

FAQE 4-5



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 64 (295) 1-15 SHTATOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

Tolerancë e patolerueshme

Nga Halil RAMA

Mbajtja forcërisht e pallatit të Kulturës të qytetit të Përmetit nga Kisha Ortodokse dhe sulmi i përsëritur i priftërinjve për ta rimarrë atë edhe pasi përmbaruesit zbatuan vendimin e gjykatës përbën një precedent tejet të rrezikshëm.

Pak ditë më parë përmbaruesit të mbështetur dhe nga policia private kanë ndërhyrë me forcë, duke larguar nga Pallati i Kulturës, ikona të Kishës, këmbana, si dhe materiale të tjera. Përmbaruesit kanë hequr kryqin nga godina e Pallatit të Kulturës dhe kanë vendosur atje flamurin shqiptar, duke zbatuar kështu vendimin e gjykatës. Për largimin e objekteve të kishës dhe priftërinjve nga kjo godinë ka pasur edhe reagime të Athinës zyrtare. Pikërisht, toleranca e autoriteteve shqiptare ndaj reagimeve të Athinës zyrtare është e patolerueshme.

Nëse besimtarët e katër besimeve fetare në vendin tonë prej shekujsh bashkëtojnë në harmoni të plotë dhe Shqipëria është ndoshta i vetmi vendi që shquhet për tolerancën fetare, dhuna e priftërinjve ortodoks të Përmetit, në një kohë që vetëpropagandohen si predikues të paqes, mbështetja, inkurajimi dhe nxitja e veprimeve të dhunshme ndaj institucioneve tona kulturore nga ana e autoriteteve të një shteti anëtar të BE-së si Greqia është në kundërshtim të hapur me normat dhe parimet e unionit europian.

Dhe si të mos mjaftonte kjo, reagimet e Athinës zyrtare u shoqëruan me masa represive ndaj shqiptarëve në pikat kufitare të Kakavijës e Kapshticës. Kësioj, Shqipëria dhe Greqia duket se po shkojnë drejt një përplasje totale për shkak të çështjes së Kishës në Përmet.

Pas kthimit në pikat kufitare doganore nga ana e palës greke të shtetasve shqiptarë, edhe pala jonë vendosi që të bëjë të njëjtën gjë.

(vijon në faqen 3)

Ruajtja dhe promovimi i vlerave të LANÇ ka qenë dhe mbetet detyrë parësore

OBVL, HISTORI SUKSESI



FAQE 2

Thaçi-Daçiç në Bruksel, takim konstruktiv, pa marrëveshje

Kosovë, përkushtim maksimal për zgjedhjet e 3 Nëntorit

Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi e Ivo Dačić, nuk janë pajtuar lidhur me dukjen e fletëvotimeve të zgjedhjeve të nëntorit në Kosovë, telekomunikacionin dhe energjinë, ndërsa janë pajtuar të takohen sërish më 8 shtator. Ata u takuan më 27 gusht në Bruksel, për të 15-ën herë për të diskutuar procesin e zbatimit të marrëveshjes së 19 prillit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, si dhe mundësinë për marrëveshje të reja që kanë të bëjnë me telekomunikacionin dhe energjinë dhe mbajtjen e zgjedhjeve...

FAQE 2

DHUNA E PREDIKUEVE TË PAQES DHE DIPLOMACIA ABSURDE E ATHINËS ZYRTARE

OBVL: Ndërhyrja e Athinës, absurde dhe e papranueshme

FAQE 3

NË PËRVJETORIN E 69-TË TË KRIJIMIT TË BRIGADËS TË 14-TË SULMUESE

Brigada e 14-të S-luftime heroike, fitore të njëpasnjëshme

FAQE 6

ME RASTIN E 52-VJETORIT

Akademia Detare, shtylla vertebrale e detarisë shqiptare

FAQE 7

Ruajtja dhe promovimi i vlerave të LANÇ ka qenë dhe mbetet detyrë parësore

OBVL, histori suksesi

Pas përmbyesjes së sistemit diktatorial të Enver Hoxhës dhe triumfit të demokracisë në Shqipëri, në dhjetor të vitit 1990, me veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që aspironin për demokraci, u formua Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL).

Kjo organizatë, që me krijimin e saj më 1994, kishte për qëllim të mbështeste proceset demokratike dhe shtetin ligjor dhe t'i bashkonte veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar në një organizatë të vetme, për të ruajtur më mirë traditat e luftës dhe të drejtat e tyre.

Organizatorët dhe nismëtarët e krijimit të OBVL-së ishin: Ymer Dishnica, Rrahman Parllaku, Nexhip Vinçani dhe Skënder Malindi, figura këto të shquara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe kuadro të devotshëm të Ushtrisë Kombëtare.

Pas një punë intensive në Tiranë dhe në rrethe të ndryshme të vendit ato organizuan degët dhe më 16 korrik 1994 mbledhën Kuvendin e parë të OBVL me veteranë nga të gjitha rrethet e vendit.

Kuvendi i I-rë i OBVL, pasi vlerësoi gjendjen në vend përcaktoi detyrat që u dilnin veteranëve të LANÇ.

Kuvendi zgjodhi kryesinë e përbërë nga Ymer Dishnica, Rrahman Parllaku, Nexhip Vinçani, Skënder Malindi, Nexhmi Ballka, Josif Zegali, Pertef Myftari, Janaq Budina, Lavdosh Dule, Koço Rafaeli, Tase Çorri, Muhamer Spahiu etj.

Pas krijimit të OBVL në qendër, u krijuan degët e OBVL të rretheve Tiranë me kryetar Muhamer Spahiu, në Elbasan me kryetar Sami Vinçani, në Korçë me kryetar Haxhi Runi, në Durrës me kryetar Idriz Hoxha, në Shkodër me kryetar Mark Uli etj.

Gjatë afro 20 viteve të ekzistencës së saj (megjithë vështirësitë e krijuara pas rebelimit të '97-tës ku iu hoqën zyrat dhe mbeti pa mjete financiare), OBVL duke punuar me përkushtim ka bërë një punë të madhe për forcimin dhe zgjerimin e radhëve të saj (sot ajo përbëhet nga mbi 15.000 anëtarë), për propogandimin dhe njohjen e vlerave të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, nëpërmjet mbledhjeve të bëra çdo vit, për përkujtimin e krijimit të çetave, batalioneve, brigadave dhe njësite partizane, si dhe duke përkujtuar figura të shquara të LANÇ, si Spiro Moisiu, Ymer Dishnica, Dali Ndreu, Nexhip Vinçani, Abdyl Këllezi, Vaskë Gjino, Tahir Kadare, Spiro Shalësi etj.



Një punë voluminoze OBVL ka bërë për plotësimin e kërkesave të veteranëve, për dhënien e Statusit që gëzojnë sot veteranët, etj.

Në periudha kritike për kombin, siç ishte lufta për çlirimin e Kosovës nga okupatori serb, OBVL ka përkrahur me të gjitha forcat popullore të Kosovës, nëpërmjet konferencave, ndihmave etj.

Në përputhje me kërkesat e programit, kryesia e OBVL ka mbajtur lidhje dhe ka bashkëpunuar edhe me shoqatat e organizatat homologë të vendeve të tjera, si me Organizatën e Veteranëve të Konfederatës së Zvi-

crës, me Shoqatën e LANÇ të Kosovës etj. Ajo sot është anëtare me të drejta të plota e Federatës Botërore të Veteranëve të Luftës e të viktimitave me qendër në Paris, ku aderohet 84 organizata dhe shoqata të veteranëve nga e gjithë bota.

Gjatë këtyre afro dy dekadave, një rol shumë të rëndësishëm ka luajtur gazeta "VETERANI" (organ i OBVL), e cila gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit që drejtohet nga kryeredaktori Halil Rama, me botimet e saj ka ngritur lart vlerat e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe të figurave të

shquara të saj; ka pasqyruar me realizëm e në vijimësi problemet që kanë preokupuar veteranët, etj.

Duke u mbështetur në Statutin e saj, OBVL ka bërë një punë të lavdërueshme edhe për pranimin në radhët e saj të pasardhësve të veteranëve, të cilët janë me qindra në të gjitha rrethet e vendit.

Aktualisht OBVL po zhvillon veprimtari të larmishme për të përkujtuar përvjetorët e 70 të krijimit të disa çetave, batalioneve e brigadave partizane (të krijuara në vitin 1943) si dhe ngjarje të tjera kulmore të historisë sonë kombëtare.

Thaçi-Daçiq në Bruksel, takim konstruktiv, pa marrëveshje

Kosovë, përkushtim maksimal për zgjedhjet e 3 Nëntorit

Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi e Ivica Daçiç, nuk janë pajtuar lidhur me dukjen e fletëvotimeve të zgjedhjeve të nëntorit në Kosovë, telekomunikacionin dhe energjinë, ndërsa janë pajtuar të takohen sërish më 8 shtator. Ata u takuan më 27 gusht në Bruksel, për të 15-ën herë për të diskutuar procesin e zbatimit të marrëveshjes së 19 prillit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, si dhe mundësinë për marrëveshje të reja që kanë të bëjnë me telekomunikacionin dhe energjinë dhe mbajtjen e zgjedhjeve për pushtetin komunal në Kosovë me tre nëntor.

Në një komunikatë për opinionin të shefes së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Catherine Ashton thuhet se, "të dy kryeministrat nënvizuan përkushtimin e tyre për



zgjedhje të suksesshme me pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme dhe konfirmuan se do të vazhdojnë përgatitjet intensive për një proces të mirë zgjedhor". Diskutimet kanë ngecur edhe rreth kërkesës së Beogradit për zgjedhje të paanshme ndaj statusit politik të Kosovës.

Kryeministri i Serbisë, Ivica Daçiç kishte deklaruar para nisjes për në Bruksel se, serbët nuk mund të marrin pjesë në zgjedhjet komunale të Kosovës më 3 nëntor, nëse në fletëvotime do të ketë shenja të sh-tetësisë së Kosovës.

Kryeministri Thaçi përsëriti se,



zgjedhjet do të mbahen në pajtim me ligjet e Kosovës, sikundër shkruan edhe në tekstin e marrëveshjes, ndërsa përgjegjësinë për dukjen e fletëvotimeve e ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ai tha se, këto zgjedhje do të jenë historike meqë zhvillohen në gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe pjesën veriore të saj, ndërsa u bëri thirrje serbëve të Kosovës, që të respektojnë afatet ligjore për regjistrimin e subjekteve politike që duan të marrin pjesë në zgjedhje, afat ky që skadon javën që po vjen. Kryeministri Thaçi, tha se bisedimet ishin konstruktive, ndonëse ende nuk është arritur pajtim as për telekomunikacionin dhe energjinë.

Kosova kërkon kodin e saj telefonik

Nga pajtimi i Beogradit varet

nëse Kosova do të fitojë kodin e saj telefonik.

Aktualisht ajo shfrytëzon kodin telefonik të Serbisë për telefoninë tokësore, ndërsa kodet e Sllovenisë dhe të Monakos, për telefoninë celulare.

Sipas delegacionit të Prishtinës në bisedimet me Beogradin, marrëveshja me të cilën pritet të pajtohet Serbia ishte që Kosova të ketë kodin ndërkombëtar, 383, ndërsa për këtë të aplikojë një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

E paqartë është edhe çështja e energjisë, meqë palët nuk kanë arritur ende pajtim për disa çështje siç është kërkesa e Beogradit për një operator të veçantë për furnizimin e komunitetit serb me energji elektrike.

Dhuna e predikueve të paqes dhe diplomacia absurde e Athinës Zyrtare

OBVL: Ndërhyrja e Athinës, absurde dhe e papranueshme

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalç-lirimtare (OBVL) dënon sulmet e paprincipita të priftërinjve ortodoksë dhe mbështetësve të tyre ndaj pallatit të Kulturës në Përmet.

Ajo i konsideron gjithashtu absurde dhe të papranueshme ndërhyrjet e Athinës Zyrtare në punët e brendëshme të Shqipërisë, pas ngjarjeve të përsëritura në Përmet. Kryetari i OBVL-së Rahman Parllaku, gjeneral-lejtnant në pension, Hero i Popullit, shprehet se "zaptimi me dhunë i Pallatit të Kulturës në Përmet nga disa besimtarë e priftërinj, nuk është as mbrojtje e ortodoksisë dhe as e Kishës në

përgjithësi, por mbrojtja e kultit të individit të Janullatos". Ai u bën thirrje besimtarëve ortodoksë që të të respektojnë të shenjta vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sikurse edhe vetë Kishën.

Ngjarjet e dhunshme në Përmet, ku disa besimtarë të verbuar dhe të urdhëruar sillen dhunshëm ndaj institucioneve shtetërore dhe historike, janë të kundraligjeshme dhe si të tilla të dënueshme.

Në këtë kontekst, OBVL dënon edhe ndërhyrjen e Kishës Ortodokse greke, si dhe reagimin që bëri ministria e Jashtme greke dhe sulmin e disa priftërinjve e besimtarëve ndaj institucionit shtetëror e kundër vendimit Gjykatës Kushtetuese.

"Besimtarët, cilitdo besimi fetar qofshin, pra edhe besimtarët

ortodoksë, duhet të dinë mirë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të shenjta, sikurse janë edhe vendimet e Kishës. Ato nuk diskutohen, sepse po u vunë në dyshim vendimet e Gjykatës Kushtetuese, atëherë, nuk ka më shtë", -shprehet z.Parllaku.

Më tej ai vijon se "Po ta shikosh në esencë, edhe ministria e Jashtme greke ka vepruar shumë keq me reagimet e saj. Fan Noli ka thënë që 'Kisha Ortodokse nuk është vetëm e ortodoksëve, por edhe e gjithë shqiptarëve".

Sulmi që iu bë shtëpisë së kulturës në Përmet nga një grup besimtarësh të orientuar nga priftërinjtë e Jnullatosit synonin për të rikthyer antiligjin. Një vendim i drejtë i Gjykatës Kushtetuese për rik-



thimin në identitet të pronës bashkisë së qytetit, është precedenti i rrezikshëm për të treguar se kemi një sulm të paprincipitë të Greqisë, jo më me armë, por me priftërinj dhe disa besimtarë të orientuar nga segmentet antishqiptare përfshi këtu edhe Janullatosin e vetë Greqinë përmes prononcimeve të bëra këto ditët e fundit.

Opinionin shqiptar dhe më tej është i njohur tashmë me një vendim të gjykatës më të lartë të Shqipërisë, siç është Gjykata Kushtetuese për rastin e shtëpisë së kulturës, ashtu si edhe në rastin e ujrave të Jonit për konfliktin mes Greqisë dhe Shqipërisë. Janë nvendime të një gjykatë supreme që nuk ka se kush ta kundërshtojë, nëse flasim për shtet ligjor. Por me këto vendime nuk është dakord vetëm Greqia dhe segmentet antishqiptare

brenda Shqipërisë. Është kjo forma e protestës që bëhet e organizuar nën vëmendjen e KOASH që hapur do të thotë sulm insatitucioneve të pavarura dhe legjitime shqiptare, është agresion i njejtë me atë që iu bë Çamërisë dhe popullatës muslimane të saj 70 vjet më parë, ku u vranë rreth 3 mijë vetë dhe u masakruan po aq të tjerë dhe u përzu me forcë një sjelljeje genocidiste popullata multsimane, duke prishur edhe xhamitë, si kulte fetare që në fakt ishte një krim kundër njerëzimit. Të njejtën politikë ndjekin edhe sot qarqe të caktuara shoviniste greke.

Pikërisht për këto arsye, OBVL u bën thirrje autoriteteve zyrtare shqiptare të reagojnë me forcë dhe të mos lejojnë në asnjë rast shkeljen e ligjeve dhe të vendimeve të gjykatave tona



Tolerancë e patolerueshme

Nga Halil RAMA

(vijon nga faqja.1)

Para disa ditësh, Drejtori i policisë kufitare në Kakavijë, Admir Abrija, ka urdhëruar zbatimin e masave të reciproritetit. Kështu, pala shqiptare ka vendosur që të kthejë prapa shtetasit grekë që kërkojnë të futen në Shqipëri. Abrija ka urdhëruar që të mos lejohen të kalojnë shtetasit grekë, nëse s'justifikojnë kalimin. Në të njejtën mënyrë veprimi edhe Drejtori i Policisë Kufitare të Korçës.

Por pikërisht kur këto veprime të autoriteteve kufitare sollën disi situatën në normalitet, edhe në Parlamentin grek është shtruar çështja e ngjarjeve në Përmet. Deputeti i partisë "Demokracia e Re", Nikitas Kakkalmanis i ka drejtuar disa pyetje ministrit të Jashtëm, Evangelos Veni-

zelos mbi veprimet që ka ndërmend të bëjë Athina zyrtare, lidhur me atë që e quajti "vandalizmin mbi Kishën e Përmetit". Në fjalën e tij deputeti i djathtë, në të njejtën linjë me neonazistët e Agimit të Artë është shprehur ndër të tjera se "ngjarjet që ndodhën në qytetin e Përmetit në Shqipëri kanë cënuar konceptin e së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane.

Në këto kushte kur edhe në organin më të lartë ligjvënës të shtetit helen kërkohet që Greqia të ndërhyjë në institucionet e BE-së, si për sa i përket financimit të një vendi që ka aplikuar dhe pret të marrë statusin e vendit kandidat, edhe për bllokada të tjera, janë të papranueshme heshjtja apo reagimi i vakët i autoriteteve zyrtare shqiptare, përveç përgjigjes diplomatike rutinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në të njejtën kohë, një tolerancë

e patolerueshme edhe nga mazhoranca e re që pas dy javësh merr drejtimin e qeverisë dhe dominimin e legjilativit. Krerët e kësaj mazhorance ngrenë zërin në kupë të qiellit, pse opozita do të marrë seli të re në një nga ish institucionet inekziste si SHQUP-i i famshëm, dhe nuk reagon për rastet e njëpeshëshme të kohëve të fundit të përballjes me shovenizmat greke si ai i Përmetit, që sinjalizojnë ogurzinë në marrëdhënjet dypalëshe. Zëvendësimi i vlerave civilizuese me ato mesjetare, jo vetëm që është i padrejtë, por është edhe i rrezikshëm për të ardhmen e këtyre marrëdhënjeve. Qëndrime të tilla të Athinës Zyrtare injorojnë dhe përbuzin shkajshmërisht vlerat civilizuese e humane të kombit tonë. Bashkë me ta injorohet edhe Kushetuta e Shqipërisë që në nenin 10 saktëson se në Republikën e Shqipërisë nuk ka

fe zyrtare dhe se shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. Parë nga ky këndvështrim, kush i ka penguar autoritetet e Kishes Orthodokse të Shqipërisë të ndërtojnë objektin e tyre të kultit edhe në Përmet.

Nëse eksponentë të mazhorancës së re kanë kërkuar deri anulimin e ndërtimit të Xhamisë së Madhe në sheshin e Namazgjasë, pse nuk reagojnë në të njejtën mënyrë edhe për "pushtimin" e pallatit të kulturës të Përmetit nga priftërinjtë ortodoksë të këtij qyteti që nuk kanë hequr dorë nga kisha e e tyre e pretenduar.

Nëse sulmi kundër xhamisë së madhe të Tiranës përmes kësaj padie të eksponentëve të lartë socialistë vjen edhe si një mjet tendencioz dhe provokim i ulët ndaj Komunitetit Mysliman, si dhe besimtarëve myslimanë, pse përdoren standarde të dyfishta në rastin e precedentit të rrezikshëm të Përmetit, kur disa priftërinj që hiqen si

predikues të paqes kryejnë akte të dhunshme.

Mbështetur pikërisht në dokumentat e arkivës së qytetit të Përmetit, Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit në Tiranë, si dhe, provave të paraqitura nga palët, Gjykata e Shkallës së Parë në Gjirokastrë në 2001-in, Apeli në 2002-in dhe Gjykata e Lartë në 2003-in, me vendim të formës së prerë vendosin që Pallati i Kulturës "Naim Frashëri" të mbetet i tillë, duke mospranuar kërkesën e Kishës Ortodokse të qytetit të Përmetit. Në 2004-ën, Gjykata Kushtetuese la në fuqi vendimet e tri shkallëve të gjyqësorisë, duke i cilësuar ato si të rregullta dhe konform Kushtetutës. Ndërkohë që në Përmet po zbatohen pikërisht këto vendime të gjykatave shqiptare, është i patolerueshëm reagimi agresiv i Athinës Zyrtare, i shoqëruar me masa represive ndaj qytetarëve shqiptarë që me pasaporta biometrike kërkojnë të lëvizin të lirë në një shtet anëtarë të Bashkimit Europian.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH-së: Forcat e Armatosura, Dy vjet në detyrë, gjeneralmajor Xhemal

Sipas shefit të SHP të FA 100-vjetori e gjeti Shqipërinë dhe FA të saj, kontribuuese të paqes dhe sigurisë kudo në botë. Viti 2013, viti i vazhdimit të modernizimit të Forcës Ajrore dhe FD, dhe procesi do të ketë në fokus FT.

Për asgjësimin e municioneve janë dhënë vlerësimi nga NATO dhe OSBE. Arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit ka qenë objektiv i rëndësishëm i FA. Stërvitja në të gjitha nivelet është parë si një tregues i rezultateve. Procesi i RSM ka qenë një nga arritjet më të mëdha të FA të MM dhe përgjithësisht të komunitetit të sigurisë në vend. Ja qëllimi i vizitave dhe konferencave të rëndësishme të organizuara në një vit

U mbushën 2 vjet kur Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi u dekretua si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Sfidat e drejtimit të tij kanë qenë të shumta, por duke parë rezultatet e arritura duket ai deri ka ditur tu bëj ballë atyre fal një punë të shkëlqyer drejtimi por dhe një bashkëpunimi po aq të mirë me Ministrinë e Mbrojtjes. Ja si shprehet në këtë intervistë gjeneralmajor Gjunkshi.

Gjeneralmajor Gjunkshi, vitin e kaluar festuam 100-vjetorin e krijimit të shtetit shqiptar dhe të FA shqiptare. 2013-ta shënoi 100-vjetorin e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, një tjetër ngjarje madhore. Si Shefi i SHP të FARSH-së, komentit juaj për këta përvjetorë të rëndësishëm për Forcat e Armatosura dhe të shtetit shqiptar?

Dua të theksoj qysh në fillim të kësaj interviste se të jesh në krye të Forcave të Armatosura në përvjetorin e 100-të të ekzistencës së shtetit shqiptar dhe të ushtrisë së tij, padyshim që është një moment shumë i veçantë dhe i pashlyeshëm në jetën e çdo ushtaraku. Momente të tilla përkojnë rrallë dhe është e kuptueshme që përveç kënaqësisë, mbarin pashmangshmërisht edhe shumë përgjegjësi. Populli dhe kombi shqiptar festuan nëntorin e kaluar një ngjarje historike, finalizimin e një ëndrrë shekullore të shkruar me gjak ndër beteja të panumërta. Një tjetër moment historik ishte edhe festimi i 100-vjetorit të Shtabit të Përgjithshëm, krijimi i të cilit daton në 4 majin e vitit 1913. Por nëse në vitin 1913 ishte në pikëpyetje fati i Shqipërisë, sot pas 100 vitesh, Shqipëria dhe Forcat e Armatosura, jo vetëm që kanë konsoliduar pozitën kushtetuese, por janë kontribuuese të paqes dhe sigurisë kudo në botë.

Para pak ditësh është nisur për në mision në Afganistan misioni "Eagle 7", si dhe është kthyer në atdhe kontingjenti i 12-të i FT. Cila do të ishte "nota" që gjeneralmajor Gjunkshi do t'u vinte efektivëve në këto misione jo vetëm në Afganistan?

Misionet që kemi pritur dhe

përcjellë këto vite kanë qenë të shumta në numër, secili me emocione të veçanta. Ushtarakët tanë, me profesionalizmin e treguar në të gjitha misionet ku janë angazhuar, padyshim që meritojnë notën maksimale. Ata kanë ditur ta mbajnë lart dhe nder flamurin kombëtar. Kontributi i FA është vlerësuar vazhdimisht nga drejtuesit e komandave të NATO-s. Ushtarakët tanë kanë treguar se janë të barabartë në profesionalizëm, ashtu sikundër kolegët e tyre pjesëmarrës në misione të Aleancës Euro-Atlantike, duke qëndruar sup më sup me partnerët e duke u konsideruar si "ambasadorët e paqes" së vendit tonë në botë. Ne jemi rreshtuar denjësisht si vend anëtar i NATO-s dhe tashmë i kemi dhënë provat e këtij përkushtimi. FA kanë një dëshmor që dha jetën në mision në Afganistan, Kapiten Feti Vogli, i cili tashmë nuk është dëshmor vetëm i Shqipërisë, por i të gjitha vendeve të NATO-s. Ne sot konstatojmë me kënaqësi se kemi fituar një eksperiencë të vyer, falë angazhimit disave për në të gjitha llojet e misioneve. Kontributet e FA kanë ardhur duke u rritur në sasi dhe cilësi, nga operacione të quajtura "forcë protection", në misione luftimi në Afganistan, deri tek misionet e trajnimit të forcave të sigurisë afgane, ku Shqipëria udhëheq ekupe trajnimit në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të Nevv Jersey të SHBA.

Prej mëse dy vjetësh në krye të FA, padyshim që keni pasur një agjendë të ngjeshur takimesh dhe vizitash, të cilat kanë ndikuar në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve në kuadrin e NATO dhe dypalëshe, si dhe kanë evidentuar përpjekjet e vendit tonë për një rol gjithnjë e më aktiv në çështjet e sigurisë. Cili është komentit juaj?

Vetë dinamika e zhvillimeve të FA dhe detyrimet në kuadrin të NATO-s dhe iniciativave rajonale padyshim që të imponojnë një axhendë të ngarkuar. Këto takime kanë qenë dhe mbeten në funksion të thellimit të bashkëpunimit me partnerët dhe aleatët, në çështje të rëndësishme të sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe të promovimit të vlerave të fqinjësisë së mirë. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore vendin tonë e kanë vizituar krerët më të lartë ushtarakë të Italisë, Turqisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, çka presupozon ngritjen e nivelit të bashkëpunimit me këto vende. Gjithashtu pjesëmarrja në takimet e komitetit ushtarak të NATO-s, në diskutimet e partnerëve strategjikë ushtarakë mbi ardhmërinë e Aleancës, si dhe një sërë vizitash zyrtare, në SHBA në fund të vitit 2012, në Gjermani, Britaninë e Madhe dhe në KFOR evidentojnë më së miri forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve jo vetëm në kuadrin e NATO-s por dhe të marrëdhënieve dypalëshe. Vendi ynë është pjesë e disa iniciativave rajonale, të cilat fokusohen në promovimin e paqes dhe sigurisë në rajon. Janë një numër i madh fushash bashkëpunimi, si stër-

vitjet e përbashkëta, kontingjentet e përbashkëta në kuadrin të A5 në Afganistan, një pamje që nuk mund të mendohej vite më parë në Ballkanin e tensioneve dhe të konflikteve.

Shqipëria ka demonstruar në mënyrë konstante rolin dhe kontributin e saj të rëndësishëm për krijimin e një rajoni ku mbizotërojnë vlerat euro-atlantike. Këtu mund të përmendim konferencën së 16-të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të FA të vendeve të iniciativës së "Kartës së Adriatikut" vjeshtën e kaluar, konferencën e 7-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të FA të vendeve të Ballkanit pak muaj më parë.

Le të ndalemi te një element shumë i rëndësishëm, siç është modernizimi i FA. Cilat janë hapat që janë ndërmarrë në këtë drejtim?

Modernizimi i FA është një proces kompleks, i cili përfshin ndryshimet thelbësore të kapaciteteve materiale për të përmbushur objektivat strategjike. Modernizimi është një aspekt shumë i rëndësishëm i integritimit në NATO. Siç përcaktohet dhe në Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2013, hartimi i projekteve të modernizimit do të vijojë të orientohet drejt zgjidhjeve të integruara dhe të plota, të shtrira në disa vite buxhetore dhe drejt krijimit të raporteve të balancuara në modernizimin e armëve dhe shërbimeve. Të gjithë jemi dëshmitarë të konkretizimit të disa prej projekteve madhore, të pajisjes të Forcave Ajrore me helikopterë të mesëm të tipit "Cougar", të Forcës Detare me anije të reja patrulluese, si dhe ngritjes së sistemeve moderne të komunikimit e komandimit - kontrollit. Viti 2013 ka qenë viti i vazhdimit të modernizimit të Forcës Ajrore dhe FD, ku sipas planit do të vijojë pajisja e helikopterëve "Cougar" me armatime e sisteme për misione luftimi dhe i anijes "Iliria" me sisteme kërkim-shpëtimi në det, për të mundur realizimin e operacioneve SAR. Procesi pas vitit 2014 dhe kryesisht në periudhën afatmesme 2016-2018, do të ketë në fokus mbështetjen buxhetore për FT, ku spikasin dy projekte kryesore, ngritja dhe modernizimi i grup-batalionit të këmbësorisë së motorizuar dhe i një kompanie të forcave speciale.

Misionit të DIE-s në vendin tonë përfundoi në fund të korrikut. Cili ka qenë kontributi i dhënë për Fa shqiptare?

Delegacioni Italian i Ekspertëve përmbylli misionin e vet 16 vjeçar në Shqipëri më 26 korrik. DIE shërbeu si element ndërlidhës dhe efikas bashkëpunimi midis Forcave të Armatosura të dy vendeve, duke i dhënë jetë një forme bashkëpunimi direkte,



e cila, nga asistencë e mirëfilltë, u transformua gjatë viteve në një organizëm bashkëpunimi duke iu referuar në mënyrë të veçantë aktivitetit formues dhe stërvitor në sektorë të ndryshëm, në shërbime dhe kompetenca të Forcave të Armatosura shqiptare për të mbërritur në marrëdhëniet e tanishme të partneritetit: nga sektori shëndetësor deri në shërbimin meteorologjik ushtarak, nga kërkim-shpëtimi dhe anti-ndotja detare deri tek xhenio ushtarak dhe mbrojtja civile.

Gjeneralmajor Jon B. Lillard, ndihmës shef i Shtabit të ACT për menaxhimin e programeve dhe planifikimin në fillim të vitit 2013 vlerësoi maksimalisht progresin e Forcave të Armatosura drejt integritimit në NATO. A mund të themi që procesi i integritimit të plotë në NATO është në rrugën e suksesit?

Procesi i RSM, ka qenë një nga arritjet më të mëdha të Forcave tona të Armatosura, të MM dhe përgjithësisht të komunitetit të sigurisë në vend. Integritimi është kryefjala e Forcave të Armatosura për vitin 2013, pasi ashtu siç është vlerësuar në Direktivën e Mbrojtjes, ky do të jetë viti i integritimit të plotë në NATO. Periudha pas anëtarësimit dhe veçanërisht viti 2012 ka shërbyer për krijimin e eksperiencës së mjaftueshme lidhur me integritimin e plotë në NATO. Bazuar në këtë eksperiencë, viti 2013 është vendimtar për realizimin e plotë të Objektivave të Planit të Integritimit në NATO. Rëndësi e veçantë nga ana jonë i është kushtuar realizimit konkret të masave të parashikuara në Planin e Integritimit me Komandën e NATO për Transformimin (ACT) dhe Komandën e Forcës së Bashkuar të Napolit (JFC-N). Në shkurt u zhvillua një Vorkshop mjaft i rëndësishëm, i drejtuar nga Gjeneralmajor Jon B. Lillard, ndihmës shef i Shtabit të ACT. Ky takim pararendës i konferencës së radhës, konsistoi në hartimin e një plani mbështetës të mirë detajuar të prioriteteve më të rëndësishme të Forcave të Armatosura. Nën autoritetin (ACT) janë zh-

villuar pesë konferenca, në përfundim të së cilave kemi vlerësuar progresin e arritur dhe kemi përcaktuar detyrat dhe sfidat që na presin. Konferenca e gjashtë dhe e fundit e integritimit do të zhvillohet brenda këtij viti, në të cilën pritet që të marrë pjesë edhe Komandanti i ACT. FA shqiptare kanë shënuar progres të vazhdueshëm sa i takon plotësimin të detyrimeve të integritimit. Përfundimi i RSM sjell padyshim përmirësim të mëtejshëm të këtij progresi.

Gjysma e parë e vitit ka shënuar një numër të madh stërvitjesh, përmendim këtu "Black Eagle 2013", stërvitjen e përbashkët në kuadrin të A5 "Joint Reaction 13", "Rreth-Grethi 2013", "Biza 2013", etj. Cili është vlerësimi juaj për rezultatet e arritura në këtë fushë?

Stërvitja vlerësohet jo vetëm si prioritet, por edhe si domosdoshmëri për realizimin e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, pasi është faktori kryesor për arritjen e standardeve në zhvillimin e forcës profesionale dhe garantimin e suksesit të misionit. Kemi organizuar disa gjatë vitit 2013 si; dy konferencat planëzuese të grupit të punës për edukimin, trajnimin dhe stërvitjen për takimin e shefave të Shtabit të Vendeve të Ballkanit të zhvilluara në Shqipëri në muajt Janar dhe Mars 2013, dy konferencat planëzuese të stërvitjes "Immediate Response" në Kroaci të zhvilluara në muajt shkurt dhe maj 2013 si dhe dy konferencat planëzuese të stërvitjes "Joint Reaction" në Shqipëri në muajt Shkurt, Prill 2013. Këto konferenca janë vetëm vazhdimi i vijimësisë të shumë konferencave dhe takimeve të ndryshme dhe në kuadrin të aleancës për stërvitjen. Gjatë 2013-ës stërvitja në të gjitha nivelet është parë si një tregues objektiv i rezultateve. Nga ana Shtabit të Përgjithshëm dhe komandave të forcave është vlerësuar stërvitja e nënrepartëve të deklaruara në "NATO Pool of Forces", disa prej të cilave janë në proces vlerësimi dhe certifikimi sipas standardeve



aset i paçmueshëm i shtetit dhe popullit shqiptar

Gjunkshi: Ja sfidat që përballuan FA

të NATO-s. Një stërvitje e suksesshme këtë vit ishte edhe stërvitja e përbashkët "Joint Reaction 13", në kuadër të (A-5) me pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. "Joint Reaction 13", shërbeu si test për vlerësimin dhe konsolidimin e kapaciteteve ushtarake për zgjidhjen e situatave të emergjencave civile dhe operacioneve SAR, si dhe për rritjen e ndërveprueshmërisë së trupave të vendeve të rajonit. Stërvitja "Biza 2013" ishte padyshim angazhimi më madhor i strukturave të FA në drejtim të përgatitjes së tyre, dhe si e tillë pati vëmendjen e duhur të të gjitha strukturave drejtuese dhe mbështetëse. Në stërvitjen "Biza '13" për herë të parë u testuan dhe u përdorën në terren pajisjet fushore të blera për FA-në, si pjesë e planit të modernizimit. Stërvitjen e përbashkët "Black Eagle 2013", të efektiveve të BFS me trupat komando të Britanisë së Madhe ne Zall-Herr si dhe stërvitja e përbashkët me rreth 3 mijë trupa angleze te cilat vijnë me një arsenal te plote anijesh, aeroplan mbajtësesh dhe avionësh te cilët do të kryejnë një ndër stërvitjet më të mëdha në rang vendi me një shtrirje pothuajse në të gjithë vendin është një tregues i qartë i rritjes së aftësive operacionale e luftarake të forcave tona të armatosura për të qenë të barabartë me ushtarakët e një vendi anëtar të Aleancës siç është Britania e Madhe.

Në Forcat tona të Armatosura bëhet një punë e gjithanshme për arsimimin, kualifikimin dhe rritjen e profesionalizmit të personelit. Cili është vlerësimi Juaj për këtë proces?

Arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit është një nga objektivat më të rëndësishëm të Forcave tona të Armatosura. Në Akademinë e Forcave të Armatosura kanë kryer gjatë këtij viti kurse të gjata apo të shkurtra trajnimit më shumë se 800 ushtarakë dhe civilë. Kjo Akademi arriti që të ndryshojë të gjitha programet e arsimimit dhe kualifikimit në përputhje me programin e konkorciut të Akademive ushtarake të vendeve të NATO-s dhe po punon për rritjen e standardeve dhe cilësisë duke aplikuar gjithashtu mësimet e nxjerra nga përvoja e kontingjenteve të forcave tona të Armatosura në operacionet ndërkombe-tare si dhe nga aplikimi i Stana-geve të NATO-s. Atje po bëhet një punë e mirë edhe për akreditimin e këtyre programeve në kuadër të arsimimit të lartë në vendin tonë, ndërsa Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes ku marrin pjesë edhe ushtarakët nga vendet e rajonit e më gjerë ka fituar nga ACT nivelin e akreditimit "NATO Listed". Për herë të parë gjatë këtij viti u zhvilluan me sukses stërvitje të dy kurseve të kësaj akademie në Qendrën e Simulimit pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes me programin e asistuar me kompjuter çka përbën jo vetëm një



risi aplikimi, por edhe unifikimin e procedurave standarde të stërvitjes së shtabeve në përputhje me standardet e NATO-s, kursimin e kohës dhe të fondeve për stërvitjen. Për FA, kjo qendër është një arritje madhore dhe bashkëkohore, e cila ka futur një standard të ri kualifikimi dhe trajnimit të efektiveve të FA në të gjitha shkallët hierarkike të saj. Në këtë aspekt dua të theksoj në mënyrë të veçantë mbështetjen që ka dhënë zyra e Atasheut të Mbrojtjes në Tiranë, zyrën e ODC në Ministrinë e Mbrojtjes, Zyra e CUBIC dhe në mënyrë të veçantë Ambasadori Amerikan në Tiranë, SHT Aleksandër Arvizu. Arritje ishte edhe përfundimi dhe dërgimi për botim i Doktrinës së Përgjithshme të FA, e cila do të shërbejë si bazë për përgatitjen e doktrinave të Forcave, manualeve por edhe për standardizimin e stërvitjes. Kam këmbëngulur që investimi ynë kryesor në FA duhet të bëhet në fushën e arsimimit dhe kualifikimit të personelit dhe në këtë drejtim kam kërkuar të përqendrohet edhe ndihma e aleatëve tanë në fushën e mbrojtjes, pasi investimi në këtë drejtim, është një investim i sigurt për të ardhmen.

Një nga arritjet shumë të rëndësishme të Forcave të Armatosura është dhe demontimi i municioneve. Sipas NATO-s, rasti i Shqipërisë është unik për demontimin e municioneve?

Asgjësimi i municioneve të tepërta ka qenë një nga objektivat më të rëndësishme për Forcat e Armatosura, pasi lidhet me sigurinë e qytetarëve të vendit tonë. Në vitin 2009 kishim mbi njëqind mijë ton municione të tepërta dhe me parametra të rënë, të cilat ishin magazinuar në 31 rajone depush, të shtrira pothuajse në gjithë territorin e vendit. Para pak kohësh përfundam asgjësimin e municioneve në

poligone të hapura, proces i cili ka qenë i vështirë. Asgjësimi i pjesë së mbetur ka vijuar në uzinat e demontimit, të cilat ofrojnë kushte të larta sigurie pasi kanë në përdorim pajisje dhe metoda moderne. Ky progres është vlerësuar së fundmi edhe në mbledhjen e Forumit për Bashkëpunim dhe Siguri të OSBE-së, zhvilluar në Vjenë gjatë muajit qershor, ku theksua se Shqipëria nga shtatori i vitit 2009 e deri në qershor 2013 ka asgjësuar rreth 90 mijë ton municione. Integrimi dhe modernizimi nuk mund të kuptohej i plotë pa marrë në konsideratë edhe procesin e demilitarizimit, në përmasat dhe dinamikën e tij. Asgjësimi i municioneve të tepërta që kemi aktualisht, do të bëjë të mundur që deri në fund të vitit 2013 të reduktohen 10 grup-depo, disa prej të cilave janë realizuar brenda 6-mujorit të parë. Kjo do të thotë më pak kosto për Forcat e Armatosura dhe më shumë siguri për qytetarët shqiptarë. Përfitoj nga rasti që në këtë kuadër, të shpreh falënderimet për të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces duke filluar nga NASA, Ambasada Amerikane, OSBE-ja, CUBIC, personelin e strukturave të specializuara të Forcave të Armatosura, punonjësit e uzinave, etj.

Një nga arritjet shumë të rëndësishme të Forcave të Armatosura është dhe demontimi i municioneve. Sipas NATO-s, rasti i Shqipërisë është unik për demontimin e municioneve?

Asgjësimi i municioneve të tepërta ka qenë një nga objektivat më të rëndësishme për Forcat e Armatosura, pasi lidhet me sigurinë e qytetarëve të vendit tonë. Në vitin 2009 kishim mbi njëqind mijë ton municione të tepërta dhe me parametra të rënë, të cilat ishin magazinuar në 31 rajone depush, të shtrira pothuajse në gjithë territorin e vendit. Para pak kohësh përfundam asgjësimin e

municioneve në poligone të hapura, proces i cili ka qenë i vështirë. Asgjësimi i pjesë së mbetur ka vijuar në uzinat e demontimit, të cilat ofrojnë kushte të larta sigurie pasi kanë në përdorim pajisje dhe metoda moderne. Ky progres është vlerësuar së fundmi edhe në mbledhjen e Forumit për Bashkëpunim dhe Siguri të OSBE-së, zhvilluar në Vjenë gjatë muajit qershor, ku theksua se Shqipëria nga shtatori i vitit 2009 e deri në qershor 2013 ka asgjësuar rreth 90 mijë ton municione. Integrimi dhe modernizimi nuk mund të kuptohej i plotë pa marrë në konsideratë edhe procesin e demilitarizimit, në përmasat dhe dinamikën e tij. Asgjësimi i municioneve të tepërta që kemi aktualisht, do të bëjë të mundur që deri në fund të vitit 2013 të reduktohen 10 grup-depo, disa prej të cilave janë realizuar brenda 6-mujorit të parë. Kjo do të thotë më pak kosto për Forcat e Armatosura dhe më shumë siguri për qytetarët shqiptarë. Përfitoj nga rasti që në këtë kuadër, të shpreh falënderimet për të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces duke filluar nga NASA, Ambasada Amerikane, OSBE-ja, CUBIC, personelin e strukturave të specializuara të Forcave të Armatosura, punonjësit e uzinave, etj.

Një tjetër arritje, për të cilën ju keni dhënë vlerësimet maksimale ka qenë programi për menaxhimin e të dhënave të personelit të Forcave të Armatosura, me mbështetjen e përfaqësuesve të CUBIC. A mund të na thoni sa e rëndësishme është kjo?

Menaxhimi i burimeve njerëzore është cilësuar si një ndër objektivat më të rëndësishëm në procesin e integritit të plotë në Aleancë, ku reduktimi i numrit të forcave dhe rritja e cilësisë së personelit është në qendër të kësaj reforme. Sjell në vëmendje faktin se prej janarit 2010 shërbimi i detyrueshëm ushtarak u

zëvendësua me shërbimin profesionist, kjo do të thotë që baza e angazhimit të Forcave të Armatosura qëndron mbi profesionalizmin, nga ushtari më i thjeshtë e deri tek gjenerali. Dixhitalizimi i të dhënave të personelit ishte një nevojë imediate, ajo është vetëm një nga objektivat tanë në këtë fushë. Gjatë vitit të kaluar strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, në bashkëpunim të ngushtë me kompaninë amerikane CUBIC, realizuan me sukses automatizimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve. Ndërthurja e këtyre sistemeve do të mundësojë menaxhimin e plotë të forcës njerëzore, oficer, nënoficer, ushtarak profesionist dhe punonjës civil, si dhe do të sigurojë marrjen e raporteve të ndryshme për kualifikime, arsimimin, gradimet etj. Strategjia e menaxhimit të personelit e mbështetur nga ACT është një reformë e suksesshme që ndikon drejtpërdrejt në menaxhimin e vlerave me të rëndësishme që kanë Forcat e Armatosura, Automatizimi i të dhënave të personelit, i kryer me asistencën e kompanisë amerikane CUBIC dhe kujdesi i treguar për arsimimin në të gjitha nivelet brenda dhe jashtë vendit do të vazhdojnë të jenë prioritet për rritjen e nivelit dhe performancës së personelit në të ardhmen. Kjo periudhë ka qenë koha e implementimit të një sistemi sa të përshtatshëm vlerësimi, motivimi dhe promovimi dhe unë do ta përkufizoja atë si një sistem sa më efektiv bazuar në vlera dhe kontribute, rregulla sa më të qarta dhe komisione karriere sa më efektive, i njëjti preokupim vlerësimi që nga ushtari profesionist deri tek gjenerali, sistem ankimi i plotë dhe të besueshëm të gatshëm për të reflektuar për një proces edhe më cilësor. Dua të theksoj faktin se komisionet e karrierës, për herë të parë këtë vit, patën mundësinë që të përdorin një dosje totalisht elektronike për të analizuar dokumentet në çdo dosje kandidati për gradim apo kualifikim. Ky fakt është një tregues i qartë në funksion të transparencës, meritokracisë dhe vlerësimit sa më objektiv të çdo ushtaraku në radhët e Forcave të Armatosura për promovimin në gradë dhe në karrierë.

Së fundmi, një mesazh nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm për gjithë efektivat e Forcave të Armatosura?

Në cilësinë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, dëshiroj të transmetoj një urim të veçantë nëpërmjet gazetës tuaj për të gjitha ata burra dhe gra nën uniformë, si dhe për punonjësit civil që shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura, përfshirë edhe ushtarakët që shërbejnë jashtë vendit. Forcat e Armatosura janë një aset i paçmueshëm i shtetit dhe popullit shqiptar.

(Marrë nga gazeta "TELEGRAF")

Në përvjetorin e 69-të të krijimit të Brigadës të 14-të Sulmuese

Brigada e 14-të S -luftime heroike, fitore të njëpasnjëshme

• *Brigadës iu ngarkua një sektor i gjerë veprimi, që përfshinte Libohovën, Pogonin, Lunxhërinë dhe deri Cepon e Rrëzomën. Goditjet e vazhdueshme të Brigadës 14-të detyruan armikun në Qarkun e Gjirokastrës të mbyllej në vende të fortifikuara. Por edhe në to, në bashkëveprim me forcat e tjera partizane, Brigada nuk e la armikun të qetë*



Inagurimi i Brigadës së 14-të Sulmuese Partizane, në fillim të muajit shtator 1944 u bë në fushën e Sheperit të rrethit të Gjirokastrës.

Në përbërjen e saj u përfshinë luftëtarët e Grupit të Parë Partizan të Kurveleshit, të Grupit të Tretë Partizan të Mallakastrës dhe të Grupit të Katërt Partizan të Çamërisë, që bënë pjesë në Zonën e Parë Operative, Vlorë-Gjirokastrë. Efektivit i këtyre reparteve të kësaj brigade ka pasur një përvojë luftarake prej më shumë se një viti, përmes aksioneve dhe luftimeve kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve, si pjesë përbërëse e grupeve prej nga kishin ardhur.

Brigadës iu ngarkua një sektor i

mbyllej në vende të fortifikuara. Por edhe në to, në bashkëveprim me forcat e tjera partizane, Brigada nuk e la armikun të qetë. Kështu, më 18 shtator ajo sulmoi e mori Kalanë e Borshit dhe futi nën kontroll pjesën më të madhe të bregdetit të Sarandës. Më 19 Shtator 1944 Brigada sulmoi armikun në Jergucat e Gjirokastrë. Në këto luftime u vranë më shumë se 15 nazistë e me qindra të plagosur. Duke vazhduar sulmin, forcat partizane çliruan qytetin e Gjirokastrës, duke zënë 250 robër dhe shumë materiale luftarake. Pas këtij suksesi, më 22 shtator 1944, Batalioni i I-rë i kësaj Brigade, në bashkëveprim edhe me forcat e Brigadës 12-të S rrethoi gjermanët në Qafën e Kakomes. Gjatë këtij

gjermanë që ishin përqëndruar në Sarandë. Në këtë luftë të ashpër që zgjati tri ditë, armiku përsëri pësoi humbje të rënda në njerëz dhe teknikë luftarake. Lufta e fundit e Brigadës së 14-të Sulmuese ishte sulmi për çlirimin e qytetit të Delvinës, ku ndodheshin 800 gjermanë të fortifikuar. Në bashkëveprim edhe me partizanët e Brigadës së 19-të S, i detyroi armiqtë të tërhiqeshin në panik nga qyteti, duke lënë në fushën e luftës mjaftë të vrarë e të plago-

u plagos edhe komisar i Brigadës Kareman Ylli, luftëtar trim në ball të luftës dhe orator i fjalës për beteja të fuqishme kundër armiqtë të Shqipërisë, nazifashistëve. Brigada e 14-të Sulmuese ruajti jo vetëm kufirin jugor, por mbrojti edhe kufirin bregdetar të Shqipërisë në detin Jon,

duke vepruar konformë udhëzimeve të Shtabit të Përgjithshëm në marrëdhënie me aleatët, të cilët vepronin në ujrat teritoriale në brigjet e Shqipërisë. Mbas çlirimit të Shqipërisë, Brigada e 14-të u vendos në kufirin Vlorë-Sazan, duke mbrojtur me besnikëri Atdheun.



gjerë veprimi, që përfshinte Libohovën, Pogonin, Lunxhërinë dhe deri Cepon e Rrëzomën. Goditjet e vazhdueshme të Brigadës 14-të detyruan armikun në Qarkun e Gjirokastrës të

luftimi u vranë 80 hitlerianë, u zunë 30 robër dhe shumë material luftarak. Më 9 tetor Brigada e 14-të, së bashku me Brigadën e 12-të mori pjesë në luftën kundër pushtuesve

sur, si dhe shumë material luftarak. Për çlirimin e Sarandës e Delvinës është luftuar deri trup me trup, duke patur të vrarë e të plagosur nga të dyja palët. Në këto luftime

Pak radhë nga jeta e familjes Xherri

Jeta është e bukur, por dhe e vështirë. Ajo ka edhe ngjarje të hidhura, siç ka ndodhur me familjen Xherri (mbiemër ky që në serbisht do të thotë "i panështruar").

Në 1944, si ish partizan po kryeja shërbimin roje. Nga larg pashe një grua të veshur me dymia, çarçaf dhe në kokë me napë të bardhë. Pasi e njoha, u takuam me lotë në sy. Pas pak Nozja nxori nga trasta ca byrekë, vezë etj. Pastaj rrobat e lara. Mori të palarat dhe kur u ngrit të kthehej për në shtëpi na tha: "Mos na turpëroni! U ruajt Zoti!"....

Kur fillova punë në ish - Goma Durrës më 1953, takova Salën, i cili punonte këtu me bashkëshorten, Nazifën. I kishte ndihuar të punësoheshin ish drejtori Haki Kokomani. Një ditë më ftuan në shtëpinë e tyre.

Mume Nozja më njohu menjëherësa më pa. Më thanë se Sala kishte qenë në burg, ndërsa e sho-

qja Nazifja me një vajzë, Xhavitën, ndërkohë që ishte shtatzënë, nuk kishte pranuar divorcin e imponuar nga eksponentët të ish Sigurimit famëkeq. I kishin internuar në Tilje, ndërsa Sala nuk kishte mundur ta shihte kurrë vajzën e pagëzuar me emrin Vjollca, e cila kishte vdekur 6-muajshe.

Më vonë ishin larguar nga Aganasi i Kavajës sepse nuk duronin dot fyerjet: tradhtar, kriminel etj. Gjatë kohës më të vështirë ata ishin ndihmuar nga familjet e partizanëve Fadil Turja, Bed Kola, Islam Haxhia etj.

Familja e Salës ishte patriote, por u godit pa mëshirë nga sistemi i diktaturës.

Nazifja, tashmë me statusin e të përndjekurës politike ruan si të shtrenjta kujtimet e bashkëshortit Sali Xherri i cili ka vdekur para 27 vitesh... I paharruar qoftë kujtimi i tij!

GENC BALLANCA

Me rastin e 52-vjetorit

Akademia Detare, shtylla vertebrale e detarisë shqiptare

• Pas viteve '90 kur tashmë vendi ynë është hapur me botën, kuadrot e dala nga Akademia Detare janë prezantuar të aftë, të zotët profesionalisht në një nivel me kolegët e tyre të flotave të Perëndimit. Kjo është manifestuar në dhjetra stërvitje të përbashkëta të Flotës Shqiptare me anijet luftarake italiane, greke e amerikane.



Nga Selman RAMA*

Më 4 Shtator 1961 në Vlorë, (pikërisht ku e pati parashikuar dijetari i shquar Sami Frashëri "Shkolla e anijerisë duhet të jetë mb'anë detit, tek të jenë edhe anijet e luftës, në Durrës, a në Ujë e Ftohtë, afër Vlorës" - vepra, fq.108) u hap për herë të parë në historinë e vendit tonë Shkolla e Lartë e Marinës, e cila fillimisht u quajti Shkolla e Oficerëve të Flotës Luftarake Detare, sot Akademia Detare.

Krijimi i shkollës së detarisë ishte domosdoshmëri, pasi tashmë vendi ynë kishte në përbërje të Flotës Luftarake dhjetra anije luftarake, ishte fuqizuar Flota Tregtare dhe ajo e Peshkimit, për drejtimin e të cilave kërkohej parasëgjithash kompletimi me kuadro të afta detare.

Para çlirimit, duke mos patur shkollat detare përparësi të kuadrove është bërë jashtë atdheut, si në Itali, Turqi, etj. Pas çlirimit, në fillim kuadrot u dërguan në ish-Jugosllavi e më pas në shkollat e larta detare të ish-Bashkimit Sovjetik. Por në vitin 1960, marrëdhënjet shtetërore midis Shqipërisë e BS u acaruan si rezultat i mosmarrëveshjeve politike midis udhëheqjeve respektive të asaj kohe. Mbi këtë bazë, më Maji 1961, BS ndërpret marrëdhënjet diplomatike me Shqipërinë dhe çdo llojë ndihme ekonomike, përfshi këtu edhe të drejtat e studimit për studentët shqiptarë që studjonin në shkollat e larta civile e ushtarake të BS. Kështu, studentët që studjonin në shkollat e larta detare të Bakus, Sevastopolit, Petërburgut, Rigës u kthen në atdhe pa mbaruar studimet. Në këto kushte, kur tashmë, siç e theksuam Flota Luftarake, Flota Tregtare dhe e Peshkimit kishin një numër të konsiderueshëm anijesh, kur kish filluar ndërtimi i anijeve në vend, qeveria e

asaj kohe mori vendimin që të hapej Shkolla e Lartë e Marinës në Vlorë.

Periudha përgatitore...

Periudha Maji-Shtator 1961 shërbeu për përgatitjen e programeve, ku punuan kuadrot më me përvojë që kishin mbaruar shkollat e Akademi në ish BS, të cilët do të ishin edhe pedagogët e parë të kësaj shkolle. Kështu vlen të përmendet puna e palodhur e pedagogëve të lundrimit detar Petrit Hysi, Mihal- laq Milkani, Aleko Stoli, pedagogëve të armëve të nënujshme Qemal Hysi, Tetem Mahmutaj; Artilerisë Bedri Hankollari, elektromekanikës e teorisë së anijes Tahir Hoxha, Llukan Shyti, të Radi- ondërlidhjes e R/Llakacionit Et'hem Shkëmbi e Petrit Cukalla, etj., grupe që udhëhiqeshin nga shefi i degës mësimore Shaqir Kapexhiu i cili kryente edhe detyrën e komandan- tit të shkollës deri në vitin 1964 kur në këtë detyrë emërohet kuadri me përvojë me dy akademi detare Azis Hasa, i cili qëndroi në këtë detyrë deri në daljen në pension duke dhënë një kontribut të çmuar në përgatitjen e kuadrove të marinës de- tare.

Ndërsa për lëndët e kulturës së përgjithshme Matematikë, Fizikë, Kimi, Elektronikë, Mekanikë Teor- ike, gjuhët e huaja: anglisht, rusisht, ekonomi politike e filozofi u bazuan në programet e Universitetit të Ti- ranës. Me këto programe punoi ped- agogu Astrit Isarai. Në saj të kësaj pune u bë e mundur që gjithshka të ishte gati për fillimin e procesit mësimor.

Kështu, më 4 shtator 1961 çelët Shkolla e Lartë e Marinës, datë e cila tashmë njihet si data e krijimit të Akademisë Detare.

Nga Akademia Detare janë diplomuar mbi 1200 kuadro

Studentët e parë ishin ata që nuk arritën të mbaronin studimet në ish BS, të ndarë në tre kurse, përkatë- sisht 18 studentë në vitin I-rë, 37 në vitin e dytë dhe 15 në vitin e tretë (sipas viteve ku kishin ndërprerë studimet jashtë).

Në shtator të vitit 1962 fillon përgatitja e kuadrove direkt nga sh-



Krijimi i shkollës së detarisë ishte domosdoshmëri, pasi tashmë vendi ynë kishte në përbërje të Flotës Luftarake dhjetra anije luftarake, ishte fuqizuar Flota Tregtare dhe ajo e Peshkimit, për drejtimin e të cilave kërkohej parasëgjithash kompletimi me kuadro të afta detare

kollat e mesme të vendit, grupi i parë 24 vetë e kështu në vazhdim deri më sot kur u mbushën 45 vjet nga hapja e saj.

Gjatë këtyre viteve u bënë për- pjekje për modernizimin e pro- grameve, përsosjes së kabineteve, laboratorëve, literaturës së nevojshme, etj; u plotësuan të gjitha kushtet për përgatitjen e studentëve sipas standarteve të kohës.

Nga Shkolla e Lartë e Marinës (Akademia Detare) janë diplomuar mbi 1200 kuadro me një mesatare vjetore 25 studentë në vit, duke plotësuar më së miri nevojat për kuadro, jo vetëm për Flotën Luftar- ake Detare, por edhe për Flotën Tregtare e të Peshkimit. Kuadro e dala nga Akademia Detare kanë qenë dhe janë shtylla vertebrale e detarisë shqiptare, mjeshtra të artit të lundrimit, të përdorimit taktik të armëve e mjeteve teknike të anijeve luftarake. Aftësitë lundruese e drej-

tuese janë manifestuar më së miri në drejtimin e anijeve luftarake e tregtare. Në krye të reparteve e nën- reparteve të Flotës Luftarake Detare janë pikërisht kuadrot që kanë mbaruar këtë Akademi Detare. Gjithashtu ata që ishin kon- tigent i Ministrisë së Transporteve kanë drejtuar me sukses anijet Tran- soqeanike "Vlora", "Tirana", "Ar- bëria", "Shkodra" me tonazh 12-16 mijë ton, në lundrime të gjata deri në Kinën e largët e Amerikën Lat- ine, duke treguar nivele ndërko- mbëtare. Kuadrot e dala nga kjo ak- ademi do t'i gjesh në drejtimin e kapitenerisë së porteve Durrës, Vlorë, Shëngjin e Sarandë duke drejtuar me kopetencë e profesio- nalizëm. Pra, si në drejtim të zba- timit të detyrave të mbrojtjes së ven- dit, ashtu edhe në transportin detar e të peshkimit roli i kuadrove që kanë mbaruar Akademinë Detare meriton respektin e duhur.

Pas viteve '90 kur tashmë vendi ynë është hapur me botën, kuadrot e dala nga Akademia Detare janë prezantuar të aftë, të zotët profe- sionalisht në një nivel me kolegët e tyre të flotave të Perëndimit. Kjo është manifestuar në dhjetra stër- vitje të përbashkëta të Flotës Sh- qiptare me anijet luftarake italiane, greke e amerikane. Tashmë në kushtet e ekonomisë së tregut e të hapjes me botën flota tregtare, e peshkimit kanë marrë një zhvillim akoma më të madh; janë krijuar kushte për zh- villimin e turizmit detar. Ndaj i takon Akademisë Detare të perfek- sionojë më tej programet për të çuar më përpara traditën tona detare, që kjo traditë e bukur e krijuar gjatë këtyre 45 viteve të ekzistencës së saj të mos venitet kurrë, por të sh- kojë drejt përsosjes së mëtejshme.

**Ish student i Akademisë Detare i vitit 1962.*

"Albanian Lion-13", një traditë stërvitje e përvitshme

Më 23 gusht 2013, në ambjentet e Komandës së Forcës Ajrore, në Rinas u zhvillua ceremonia e hapjes së stërvitjes së përbashkët midis Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe dhe Forcave të Armatosura shqiptare të koduar "Albanian Lion-13".

Kjo ceremoni, zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis FA të Shqipërisë dhe FA të Mbretërisë së Bashkuar. Trupat ushtarake të Forcave Ajrore britanike u pritën në aeroportin Rinasit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, ambasadori i Britanisë së Madhe në Tiranë, z. Nicholas Cannon, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja, zëvendësambasadori i Britanisë së Madhe, z. Stephen Hickling, konsulli, z. Kabir Rahman, zëvendëskomandanti i brigadës së 3-të, Komando të Royal Marines, kolonel Kevin Oliver, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

Më pas për të pranishmit në këtë aktivitet u zhvillua një demonstrim i përbashkët i Forcave Ajrore britani-

ke dhe Forcave Ajrore të Shqipërisë.

Pas përfundimit të demonstrimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se: "Kam privilegjin, nderin dhe kënaqësinë e veçantë si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të jem sot këtu dhe të mbaj fjalën e mirëseardhjes në ceremoninë e hapjes së stërvitjes së përbashkët midis Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe dhe vendit tonë, të koduar "Albanian Lion-13".

Sot, ka vijuar më tej gjeneralmajor Gjunksi, pas kaq shumë vitesh, fati e do që stërvitja "Albanian Lion-13" të bëhet një traditë stërvitje e përvitshme midis dy vendeve tona.

Për të menaxhuar dhe koordinuar këtë aktivitet stërvitor, janë ngritur struktura e grupe koordinuese - mbështetëse në të gjitha nivelet dhe rajonet ku do të zhvillohen aktivitetet stërvitore, duke nisur nga Shtabi i Përgjithshëm i FA, për të vijuar me të gjitha hallkat e zinxhirit të komandimit.

Më tej gjatë fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm ka garantuar se me nderim, besim dhe devot-



shmëri Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dhe do të jenë gjithmonë të gatshme për të kontribuar në rritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimin dypalësh me Mbretërinë e Bashkuar si dhe me Forcat e vendeve të tjera anëtare të NATO, në përputhje me misionin e saj kushtetues.

Në fund të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Gjunksi, pasi ka falënderuar për prezencën trupat pjemarrëse në këtë demonstrim u ka uruar atyre stërvitje të suksesshme, i ftoi ato për të punuar së bashku për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ndërmjet Forcave tona të Armatosura, për të përballuar sfida të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes".

Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe, z. Nicholas Cannon në fjalën e tij u shpreh se "Është një kënaqësi e veçantë të jem sot këtu me shefin e Sh-

tabit të Përgjithshëm dhe me ushtarakë të lartë shqiptarë dhe britanikë për t'ju paraqitur ju fillimin e stërvitjes "Albanian Lion-13". Përgjatë tre viteve të fundit FA shqiptare së bashku me ambasadën që unë drejtoj dhe me autoritetet ushtarake në Londër kemi punuar për krijimin e mundësive për stërvitje të përbashkëta në Shqipëri. Më tej ambasadori Cannon ka theksuar se këtë vit stërvitja do të drejtohet nga gjenerali Davis, komandant i Forcave Anfibe Britanike. Kjo stërvitje i mundëson gjithashtu oficerëve dhe personelit ushtarak të dy vendeve të familjarizohen me punën së bashku, në kuadër të Aleancës Euro-Atlantike. Të dy palët kanë shumë për të mësuar nga njëra tjetra. Këtë vit, është shprehur më tej ambasadori Cannon, kemi pasur për herë të parë në stërvitje edhe një kontingjent të trupave hollandeze. Në përfundim të fjalës së tij ambasadori britanik, Nicholas Cannon u shpreh: "Dua të falenderoj ushtarakët shqiptarë dhe autoritetet civile të cilat i dhanë jetë këtyre mundësive stërvitore për ne. Dua të theksoj se ne i jemi shumë mirënjohës publikut sh-

qiptar për mikpritjen e tyre, durimin dhe bashkëpunimin gjatë kësaj stërvitjeje.

Stërvitja e përbashkët "Albanian Lion-13", është një stërvitje shumë skenarësh, ku marrin pjesë rreth 3000 trupa britanike, kryesisht komando dhe forca detare, si dhe një efektiv prej 35 ushtarakësh nga Forcat e Armatosura hollandeze, të cilat operojnë së bashku me trupat britanike.

Teatri i stërvitjes së përbashkët shqiptaro-britanike "Albanian Lion-13" ka një shtrirje të gjerë gjeografike, duke filluar prej rajonit stërvitor të Bizës, në Pashaliman, Kuçovë, Karaburun dhe Sazan. Forcat e Armatosura do të angazhohen në stërvitje me trupa dhe mjete të Forcës Detare, si dhe trupa të Forcës Tokësore, në realizimin e skenarëve të përbashkët.

Stërvitja e përbashkët "Albanian Lion-13" përfshin në vetëvete tre stërvitje, secila me një skenar të caktuar. Gjatë periudhës njëmuajore të qëndrimit në vendin tonë, trupat britanike do të realizojnë dhe kryerjen e veprime ushtarake në det dhe në tokë në operacione të evakuimit, zbarkimit detar, qitje, etj.



Mënyra të reja për "të djegur" yndyrat e tepërta në organizëm

Mjekët mendojnë se shkaqet kryesore të shtimit në peshë, janë katër: së pari, ushqimi joracional, lëvizjet e pakta, ekuilibri i çrregulluar në jetën e përditshme, d.m.th., një reagim jo adekuat ndaj stresseve, gjumi i tepërt, sidomos gjate ditës dhe, marrja e preparateve hormonale. Po si mund të shpëtojmë nga peshja e tepërt? Ja disa mënyra të thjeshta.

Mënyra e parë: Dhjami mund të "shkrihet" fare mirë nëpërmjet disa ushtrimeve që kanë si bazë frymëmarrjen: duhet të marrësh frymë thellë dhe aktivisht, gjithmonë me hundë. Filloni ngadalë dhe shtojeni

ritmin vazhdimisht, duke i shëmbëllyer, si të thuash, një lokomotive kur niset për udhëtim. Pas një cikli prej tridhjetë frymëmarrjesh të tilla, pushoni pak. Këtë ushtrim duhet ta përsëritni pesë herë në mëngjes dhe në mbrëmje.

Mënyra e dytë: Të pini ujë të ngrohtë: Sa herë që ndjeni uri, në vend të që të hani, pini një gotë me ujë të ngrohtë, ku keni hedhur paraprakisht një lugë mjaltë dhe disa pika lëng limoni ose uthull molle.

Mënyra e tretë: Me anë të ushqimit. Ja thelbi i saj: në ditën e parë duhet të hani vetëm mish të zier, në të dytën

të pini vetëm kos, në të tretën të hani vetëm mollë, në të katërtën të ushqeheni vetëm me peshk, në të pestën të hani vetëm oriz, në të gjashtëm vetëm lakror me lakra, në të shtatën, pulë të zier.

Pas një jave filloni përsëri nga e para. Kjo dietë nuk duhet të vazhdojë më shumë se dy javë, brenda të cilave ju do të bini 7 kilogramë.

Këshilla e fundit: Mos u mundoni të hiqni menjëherë mbipeshën. Mbani parasysh se është më i mirë mjekimi gradual me metoda të natyreshme, sesa kurimi i menjëhershëm me mjete drastike.

